KËRKESË
Nr. 209/7, datë 9.11.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike 'Burdullias', Berat", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 491,260 (katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" është bërë bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 491,260 (katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE 'BURDULLIAS', BERAT"												
NR.	**P R O N A R I**							**VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM**				**SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)**
								"ARË"			**VLERA TOTALE (lekë)**	
	Emri	**Atësia**	**Mbiemri**	**Z. kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja Totale**	**Sipërfaqja (m^2)**	**Çmimi (lekë/m^2)**	**Vlera (lekë)**		
	A	*B*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*L*	*M*	*N*	*Y*	*Z*
1	**Myfarete**	**Iljas**	**Peshtani**	**8501**	**4/149**	**arë**	**2420**	**2420.0**	**203**	**491,260.00**	**491,260.00**	**Konfirmuar nga ASHK-ja**
	Feride	**Ibrahim**	**Bego**									
SHUMA										**491,260.00**	**491,260.00**	

Shënime.

Vlerësimi i pasurisë "arë" është bazuar në VKM-n nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.